



Projekti financohet
nga Bashkimi
Evropian



Qendra për Promovimin e
Konkurrueshmërisë



TIRANA REGIONAL
DEVELOPMENT AGENCY

IPA Civil Society Facility and Media Programme 2016-2017

Support to Civil Society Organizations capacities

Reference: EuropeAid/138384/ID/ACT/AL

Titulli i Projektit: “Mbështetja e Organizatave të Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale në Shqipëri”

Nr. Kontratës: 2018/396114

DOKUMENT POLITIKASH

mbi

Mjedisin Ligjor të sektorit të NS, gjetjet dhe sfidat

Janar 2019

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e organizatave të kontraktuara dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

I.	Hyrje	3
II.	Ekosistemi aktual i Ndërmarrjeve Sociale	5
III.	Korniza ligjore dhe boshllëqe të NS-ve	7
IV.	Gjetjet nga konsultimet me fokus grupet	12
V.	Konkluzione mbi kuadrin ligjor	14
VI.	Qasje e Politikave në mbështetje të Sipërmarrjes Sociale	16
VII.	Rekomandimet e politikave për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale	18
	<i>7.1 Masat legjislative dhe rregullatore</i>	18
	<i>7.2 Masat mbështetëse institucionale dhe platformat e rrjetëzimit për ndërmarrjet sociale</i>	20
	<i>7.3 Masat e kornizës financiare</i>	20
	<i>7.4 Masat e lidhura me edukimin</i>	21
	<i>7.5 Promovimi i një kulture të sipërmarrjes sociale</i>	21
	<i>7.6 Masa për të promovuar Sipërmarrjen Sociale</i>	22
VIII.	Përfundime dhe Rekomandime të përgjithshme të politikave	24
IX.	ANEKSE	26
	<i>Aneks 1: Metodologjia e organizimit të mbledhjeve të fokusgrupeve</i>	26
	<i>Aneksi 2: Lista e pjesëmarrësve në Vlorë</i>	28
	<i>Annex 3: Lista e pjesëmarrësve në Tiranë</i>	29
	<i>Aneksi 4: Bibliografia</i>	30

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale”, e cila po zbatohet nga Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë, në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zhvillimit Tiranë, nga periudha prilli 2018 deri në shtator 2020. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë zhvillimin e një modeli të ri biznesi për organizatat e shoqërisë civile, për zhvillimin socio-ekonomik, që ka në fokus veçanërisht përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara.

Ky dokument i politikave analizon kuadrin ligjor të Ndërmarrjeve Sociale (NS) në Shqipëri, mënyrën si i mbështetet kuadri ligjor aktual OShC-të, për të krijuar ndërmarrje sociale, cilat janë boshllëqet dhe vështirësitë e identifikuar në procesin e zbatimit të Ligjit, për të ofruar disa rekomandime politikash në lidhje me zhvillimin e sipërmarrjes sociale në Shqipëri.

Përgatitja e këtij dokumenti ka kaluar përmes procese konsultimesh. Nëpërmjet zbatimit të udhëzuesit metodologjik për konsultimet, takimet e fokusgrupeve u orientuan, me qëllim që të merrej nga pjesëmarrësit informacioni më i rëndësishëm për çështjet e sipërpërmendura, në lidhje me kornizën ligjore të SE dhe politikat më të rëndësishme në sipërmarrjen sociale.

Organizimi i konsultimeve / diskutimeve të grupeve të fokusit të zhvilluara në Vlorë dhe Tiranë dhe intervistave të tjera individuale, synoi të përthithte perceptimet reale të barrierave kryesore për rritjen dhe zhvillimin e sektorit të NS, si dhe të krijonte një pasqyrë dhe analizë të kuadrit rregullator, mundësitë e financimit dhe strukturat mbështetëse në dispozicion.

Ligji Nr.65 / 2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë» është në fuqi, por ende nuk po zbatohet plotësisht. Asnjëra prej organizatave nuk ka marrë ende statusin e SE. Aktet nënligjore / aktet plotësuese që lehtësojnë zbatimin e Ligjit, janë përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por ka mungesë informacioni mbi zbatimin real të Ligjit dhe është vërtet e vështirë të matet ndikimi real i kuadrit ligjor të NS, në vend.

Nga fokusgrupet e organizuara në dy qytetet, Vlorë dhe Tiranë, u theksua nevoja e informimit dhe promovimit të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të NS. Aty u identifikuan llojet e mbështetjes institucionale, mekanizmat financiarë dhe nevoja për përmirësimin e legjislacionit. Duke propozuar dhe organizuar një kuadër politikash, ndërmarrjet sociale do të kishin më shumë ndikim kur të kërkojnë ndryshime institucionale.

Zhvillimi i politikave në mbështetje të NS-ve do të jetë më efektiv, nëse ato ndërtohen nëpërmjet bashkëpunimit horizontal (duke punuar me të gjitha institucionet qeveritare) dhe bashkërendimit vertikal (duke punuar me të gjitha nivelet e pushtetit lokal), si dhe bashkëpunim me shumë aktorë të tjerë. Nuk mjafton të flitet për rëndësinë e NS dhe për ndikimin e tyre

në zhvillimin social-ekonomik, por është e nevojshme edhe ndërmarrja e disa disa veprime politikash konkrete. Përtej përmirësimeve në kuadrin ligjor ekzistues të NS, nevojitet përshtatja e një strategjie për sipërmarrjen sociale, me masa konkrete që duhet të sjellin rezultate konkrete dhe efikase në mbështetje të zhvillimit të NS.

Strategjia e propozuar për sipërmarrjen sociale duhet të synojë krijimin e një mjedise të përshtatshëm dhe të fokusohet në katër fusha prioritare të politikave për NS:

- (i) Zhvillimin dhe përmirësimin e kuadrit legjislativ dhe institucional;
- (ii) Krijimin e një kuadri financiar adekuat dhe mbështetës;
- (iii) Promovimin e rëndësisë dhe rolit të sipërmarrjes sociale nëpërmjet edukimit formal dhe joformal;
- (iv) dhe promovimit të ndërmarrjeve sociale në të gjithë vendin.

Procedura e propozuar pjesëmarrëse, nëpërmjet krijimit të grupit të punës dhe më pas institucionalizimit të këshillit konsultativ do të mundësojë bashkëpunimin e shumë palëve për finalizimin e dokumentit të politikave mbi sipërmarrjen sociale.

Që prej dy prej miratimit të ligjit 65/2016 për NS-të, është shumë e vështirë të identifikohet ndonjë NS, e cila të ketë fituar statusin NS.

Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale duhet të përgatisë detyrimin e mbetur të ligjit “Për krijimin e rregjistrimit të NS-ve, rregullat e detajuara për formatin dhe përmbajtjen e tij”, sipas nenit 15, pikës 2 të ligjit 65/2016 për NS-të, e cila nuk është realizuar ende.

Organizatave jo-fitimprurëse (OJF-të), të cilat janë potenciale për t’u konsideruar nën statusin e NS-ve, veprojnë në fusha të ndryshme aktivitetesh të krijuara me mbështetjen e donatorëve, më së shumti në agrikulturë, edukim, shërbime sociale dhe shëndetësore ndaj njerëzve në nevojë, trajnime profesionale, punësim dhe turizëm. OJF-të shqiptare me karakteristikat e një NS-je janë entitete të vogla me mesatarisht më pak se 10 punonjës¹.

Ato kryesisht mbështeten në grante dhe fonde filantropike për investimin fillestar dhe kostot operacionale.

Masat aktive të punësimit nuk janë gjithmonë të përshtatshme për NS-të, pasi ato shpesh nuk kanë kapacitetin financiar për t’i mbajtur punonjësit për periudha të gjata. Sektori i NS-ve mbështetet në financimin prej donacioneve, me përjashtim të disa OJF-ve të cilat kanë bërë përpjekje për t’u përshtatur në mënyrë që të krijojnë një model të qëndrueshëm biznesi.

Skemat mbështetëse të sektorit publik për ndërmarrjet sociale nuk janë akoma prezente në Shqipëri, por konsiderohet një hap pozitiv krijimi i Fondit të Ndërmarrjes Sociale².

Qëllimi kryesor i kësaj skeme nga buxheti i shtetit është të rrisë punësimin e individëve nga grupet më vulnerabël dhe të disavantazuar, të cilët në fakt mbështeten nga Skema e Ndhmës Ekonomike Sociale. Objektivi i skemës së ndihmës shtetërore është të mbështesë zhvillimin dhe transformimin e organizatave të shoqërisë Civile me statusin jo-fitimprurës që të fitojnë statusin e ndërmarrjes sociale. Kushti paraprak që një OSHC (CSO) e rregjistruar ligjër-isht, që të përfitojë statusin e NS-së dhe rrjedhimisht të përfitojë nga ndihma shtetërore duhet të përmbushë, praktikisht, kriteret sociale dhe ekonomike.

Skema e ndihmës shtetërore në formën e grantit, e dhënë në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit, arrin një vlerë totale ALL 249,760,000, me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh për periudhën 2019-2021. Skema e grantit do të mbulojë 70% të kostove të pranueshme të miratuara nga komisioni i vlerësimit, por jo më tepër se 1,500,000 ALL, nëse entiteti është i aftë të financojë pjesën e mbetur të investimit. Kostot e pranueshme të cilat konsiderohen për financim me ndihmë shtetërore, lidhen me tre kategori kryesore:

- i) Investim në makineri dhe pajisje për realizimin e produktit/shërbimit;
- ii) Kualifikim dhe trajnim për të rritur aftësitë profesionale të punonjësve të rinj, që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të disavantazuar. Dhe
- iii) Mbulojnë deri në 50% të pagës minimale për punonjësit e rinj, që bëjnë

¹ Social Economy in Eastern Neighbourhood and in the Western Balkans Country report – Albania -January 2018

² Gov.decreed no.85,,date 25.06.2018, authorization of the state aid for establishing the SE Fund.

pjesë në kategoritë e grupeve të disavantazuar për një periudhë 6-mujore.

Ka disa skema financiare shtetërore që shërbejnë si grante për NVM-të si: Fondi i Konkurrueshmërisë, Fondi i Ekonomisë Kreative, Fondi i Sipërmarrjes dhe Fondi i Inovacionit. Fonde të tilla shtetërore menaxhohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), por deri më sot, nuk janë të aksesueshme nga NS-të, dhe kjo duhet të ndryshojë. Është e nevojshme të bëhen ndryshime në dekretet ekzistuese të qeverisë, për fondet e sipër-përmendura, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe gjithashtu në VKM-të që zbatohen nga AIDA.

Ndërmarrjet sociale kanë nevojë për asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh, për të kuptuar më mirë opsionet e mundshme të financimit dhe për të pasur mundësinë të menaxhojnë forma të ndryshme të huave apo investimeve.

Ndërtimi i kapaciteteve është thelbësor për zhvillimin e biznesit dhe planeve operacionale, ku përfshihen, analizë të detajuar financiare, dhe planet e marketingut, si dhe testimi dhe përcaktimi i modelit të biznesit. Ndërtimi i kapaciteteve shërben për të zvogëluar rrezikun për investitorë që duan të shohin kapitalin e tyre të ripaguhet. Nga ana e ofertës, përveç Yunus Social Business Balkans-Albania, nuk ka asnjë suport tjetër financiar për NS-të.

- Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet kryesore financiare ende nuk i kanë identifikuar ndërmarrjet sociale si klientë të mundshëm.
- Përfaqset inovative afatgjata të bazuara në partneritetin publik-privat nuk janë të pranishme, të cilat do të shërbenin për të krijuar një infrastrukturë të qëndrueshme mbështetëse për fazat e ndryshme të zhvillimit të një ndërmarrje sociale.
- Huadhënia komerciale nga bankat nuk ekziston.
- Sektori privat luan rol të limituar në mbështetjen financiare të sektorit të NS-ve.
- Mënyra të tjera financimi si psh. financimi nga investitorët 'ëngjëj' nuk ekzistojnë, ose kanë treguar shumë pak interes në këtë fushë.

Si pasojë e mungesës së ekzistencës së burimeve financiare, ka një interes të ulët mbi sipërmarrjen sociale, mungesa e mekanizmit koordinues dhe monitorues dhe krijimit të një rrjeti të NS-ve, lind domosdoshmëria që **kuadri legjislativ** duhet të sigurojë një strukturë të qartë dhe transparencë, lidhur me mekanizmin koordinativ institucional të sektorit të NS-ve. Kufizimet ekzistente në karakterin jo-fitimprurës të NS-ve mund të konsiderohen si një pengesë për rritje të mëtejshme në sektorin e NS-ve pasi këto kufizime dekurajojnë edhe investimin e impaktit. Derisa të përfundojë puna për një kuadër legjislativ të plotë, sektori i NS-ve do të vijojë të të përballlet me vështirësi dhe mundësi financiare të kufizuara.

Shembulli unik në Shqipëri i një ndërmarrje sociale të stabilizuar është **YAPS** (Youth Albania Professional Services). Është një ndërmarrje fitimprurëse sociale në rritje, e cila e ka nisur jetën si një ndërmarrje komerciale jashtë traditës së shoqërisë civile. YAPS është një 'biznes social', një ndërmarrje biznesi që operon brenda rregullave të tregut por nxitet nga objektiva sociale. YAPS është biznesi i parë social në Tiranë. Kompania punon në fushën e shërbimit për dërgesa pakosh, pastrime dhe riparime. U themelua në 2001 dhe momentalisht punëson 112 individë. Punonjësit janë jetimë, romë, egjiptianë ose individë që kanë patur vështirësi financiare dhe trajnohen përpara se të punësohen nga kompania. Pas disa financimeve fillestare, YAPS është tashmë një kompani komerciale e mirëfilltë.

3.1 Përshkrime të shkurtra të ligjit 65/2016 mbi NS-të

Disa pika kryesore të ligjit mbi NS-të janë:

- Miratimi i ligjit 65/2016 mbi NS-të konsiderohet një hap pozitiv i ndërmarrë nga qeveria shqiptare. Ky ligj synon të rregullojë aktivitetet dhe kushtet për funksionimin e ndërmarrjeve sociale, që rregullohet në mënyrë eksplicite në legjislacionin shqiptar.
- Forma ligjore e NS-së është ajo e një organizate jo-fitimprurëse, që bazohet kryesisht mbi ligjin Nr. 8788, që daton në 7 Maj 2001, 'Mbi organizatat jo-fitimprurëse'. Rregullimet ligjore të legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe kompanitë e thjeshta nuk përputhen me kërkesat dhe parimet e përgjithshme të funksionimit të subjektit 'ndërmarrje sociale'.
- Nga ana tjetër, ligji mbi organizatat jo-fitimprurëse rregullon kriteret dhe parimet e funksionimit të 'ndërmarrjes sociale', meqënëse aktivitetet jo-fitimprurëse përkufizohen si çdo aktivitet ekonomik ose jo-ekonomik, me kushtin që të ardhurat ose asetet të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve në të mirë të interesit publik.
- Ky ligj njih vetëm organizatat jo-fitimprurëse që realizojnë produkte dhe/ose shërbime në fushat e mëposhtme: shërbime sociale, punësim i grupeve të pafavorizuara, punësim i rinisë, shëndetësi, arsim, mjedis, promovim të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë, aktivitete sportive dhe promovim të zhvillimit të komunitetit lokal.
- NS-të duhet të përmbushin minimumin e kriterëve sociale dhe ekonomike për të fituar dhe mbajtur statusin e një ndërmarrjeje sociale. Një ndërmarrje sociale duhet të ketë të paktën tre punonjës me kohë të plotë, dhe të paktën 30% e punonjësve të jenë prej grupeve të pafavorizuara. Shpërndarja direkte ose indirekte e fitimit është e ndaluar. Për më tepër, kërkon pjesëmarrje kolektive nga punonjësit dhe pale te tjera te interesuara në marrjen e vendimeve.
- Statusi i ndërmarrjes sociale jepet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ligji është mjaft kufizues në përdorimin e titullit 'Ndërmarrje Sociale'. Nëse një entitet ligjor identifikohet si i tillë pa marrë konfirmimin zyrtar nga ministria, bëhet subjekt i një gjobe prej 220-290 EUR.
- Sipas këtij ligji, karakteristikat kryesore të një ndërmarrjeje sociale janë: zhvillimi i një aktiviteti të vazhdueshëm për prodhimin dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve, promovimi i objektivave sociale, mos-shpërndarja e fitimit, vendimmarrje kolektive me pjesëmarrjen e themeluesve, punonjësve dhe gjithashtu nga kliente që marrin produktet dhe shërbimet, investimi i të ardhurave që gjenerohen nga aktiviteti ekonomik për zgjerimin e vazhdueshëm të aktivitetit.
- Statusi ligjor i NS-së mundëson financimin e tyre nga burime publike dhe private. Ligji ofron burime për sigurimin e mjeteve financiare bazuar në: (i) fillimisht të ardhurat nga shitja e produkteve dhe nga tarifat e shërbi-

meve, (ii) subvencionet publike të lidhura me statusin e tyre social dhe punësimin, (iii) misione mbështetëse dhe (iv) donacione private. Gjithashtu ligji lë të hapur mundësinë për të gjeneruar të ardhura nga çdo burim tjetër i njohur nga legjislacioni në fuqi.

- Ligji nuk ofron regjim të veçantë fiskal për ndërmarrjet sociale. Ato do të jenë subjekt i zbatimit të legjislacionit fiskal për kategorinë e taksapaguesve në të cilën bëjnë pjesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Ndërmarrjet sociale mund të mbështeten nga shteti nëpërmjet subvencioneve. Subvencionet publike duhet të jenë të lidhura ngushtësisht me misionet e tyre të mbështetjes sociale dhe punësimit. Format e subvencioneve për ndërmarrjet sociale të rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me Autorizim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. NS-të janë subjekt i implementimit të legjislacionit fiskal për OJF-të.

3.2 Vlerësim i përgjithshëm /konsiderata per ligjin 65/2016.

Vlerësimet e përgjithshme dhe konsideratat janë listuar bazuar në analizën e përgjithshme të ligjit, informacionin e mbledhur në takimet e fokus-grupeve, intervistat individuale³ me disa organizata të tjera, mundësite për të ngritur ndërmarrje sociale në Shqipëri, etj.

- Ligji ndihmon sipërmarrjen sociale, si një mjet për integrimin social dhe ekonomik të individëve të pafavorizuar nëpërmjet punësimit të tyre, më tepër se sa per fuqizimin e NS-ve, për sigurimin e llojshmerise se produkteve dhe shërbimeve të ndryshme shoqërore.
- Ligji i NS-ve duket si një shtojcë e ligjit të OJF-ve, pasi sipas ligjit, vetëm OJF-të mund të ngrenë sipërmarrje sociale; I jep statusin e ndërmarrjes sociale vetëm organizatave jo-fitimprurëse. Kjo formë ligjore përjashton forma të tjera ligjore si psh: biznesin social dhe kooperativat pa njohjen zyrtare dhe mund t'i përjashtojë këto nga programe publike mbështetëse në të ardhmen. Kjo mund të frenojë shpirtin sipërmarrës të shumë individëve të cilët mund të përfshiheshin në biznese sociale.

Per momentin, ligji i miratuar për Ndërmarrjet Sociale është kufizues, duke u parë ngushtësisht si një instrument për politikën sociale, dhe nuk adreson gjithë panoramën e gjërë të sektorit. Për më tepër, mund të rrezikojë njohjen publike dhe rritjen e ndërmarrjeve sociale ekzistuese. Disa nga palët me interes të intervistuar besojnë se edhe pse ligji synon pozitivisht punësimin e grupeve të pafavorizuar, përgjithësisht është kufizues dhe mund të vështirësojë zhvillimin e çdo sektori inovativ të NS-ve.

Do të ishte mirë nëse ligji do t'i trajtonte temat më gjerësisht dhe të inkurajonte shtrirjen e ndërmarrjeve sociale në të gjithë sektorët, dhe të jepte një model me 'formë ligjore' specifike sesa një status.

- Përgjithësisht, ligji krijon përshtypjen se NS-të janë struktura që përmbushin kriteret e përcaktuara ekonomike dhe sociale, por nuk e ndan specifikisht aktivitetin ekonomik të NS-s nga aktiviteti normal i një OJF-je. Psh. ligji përcakton se që në ditën e parë që një NS hap aktivitetin e saj, duhet të deklarojë të paktën **tre punonjës**, çka konsiderohet e pamundur për një ndërmarrje sociale, edhe duke marrë në konsideratë aktivitetin

³ Social Business Initiative: Creating a favourable climate for social enterprises, key stakeholders in the social economy and innovation, 25 October 2011 COM(2011) 682)

ekonomik modest të NS-së/OJF-së fillestare; qofshin këto shifra të llogaritura vetëm për aktivitetin ekonomik ose për gjithë aktivitetin e organizatës. Gjithashtu, **në rast dështimi**, asetet e saj merren nga shteti ose i jepen një ndërmarrjeje tjetër. Nëse një NS dështon në aktivitetin e saj ekonomik ajo mund të vazhdojë si një OJF, por Ligji e konsideron një NS si një strukturë të vetme.

- Në praktikë, ligji mundëson statusin e NS-së, por nuk ofron asnjë mbështetje konkrete ose stimul fiskal.
- Ligji ofron mundësi për pjesëmarrje në **prokurime publike**, por nga ana tjetër ligji mbi prokurimet publike ndalon OJF-të nga pjesëmarrja në tendera; dhe në përgjithësi, ligji krijon më shumë kufizime sesa përfitime. Politikat e prokurimit publik⁴ nuk parashikojnë kontrata për NS-të dhe OSHC-të, as përfshijnë ndonjë kriter social dhe mjedisor. NS-të janë të disavantazuara në proceset e tenderave pasi këto procese nuk marrin në konsideratë natyrën unike të NS-ve apo përfitimet sociale që mund të vijnë nga alokimi i kontratave. NS-të dhe OSHC-të janë gjithsesi hezituese për të marrë pjesë në proceset e prokurimit publik pjesërisht pasi shpesh nuk informohen mbi këto thirrje, dhe pjesërisht sepse dyshojnë në paanshmërinë këtij procesi. Ligji nuk i referohet dispozitave të kontratave të siguruara apo ndonjë trajtimi preferencial në prokurimet publike apo ndonjë përfitimi specifik lidhur me taksat.
- Subvencionet publike mund të ofrohen gjithashtu nga njësitë e qeverisjes vendore, por duhet të jenë parashikuara në buxhetet përkatës dhe duhet të administrohen me vendime të këshillit bashkiak.
- Trajtimi i TVSH-së, kryesisht për NS-të nuk është plotësisht i qartë. OJF-të janë automatikisht të rregjistruara për TVSH dhe duhet të kërkojnë përjashtim tek autoriteti i Tatimeve.

3.3 Vlerësime specifike dhe mangësi në ligjin e NS-ve.

- **Neni 5 (Promovimi i NS-ve nga shteti)**, në pikën 1 lidhur me masat mbështetëse përfshihen: masa të tjera financiare! Nga pikëpamja legislative, kjo dispozitë nuk përcakton se cili institucion ka përgjegjësinë e **zbatimit** të këtyre masave. Edhe Urdhri mbi Manualin e Promovimit të zhvillimit të ndërmarrjeve Sociale dhe Plani i Veprimit nuk dedikojnë një buxhet specifik për të. (Deri tani, përveç buxhetit shtetëror, promovimi do të realizohet nëpërmjet projekteve ose donatorëve të tjerë).
- **Neni 6 (Roli i njësive të qeverisjes vendore)**, në pikën 2, vërtet pengesa bazike është ligji ekzistues mbi prokurimet publike, i cili nuk i jep akses OSHC/NS-ve. Lind domosdoshmëria për të rishikuar ligjin dhe për të përfshirë **parimet e prokurimit social**.
- **Neni 8 (Kriteri ekonomik), pika 2**, theksohet qartë se një NS duhet të veprojë vazhdimisht në fushën e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve. Të paktën 20% e të ardhurave duhet të gjenerohen pas vitit të dytë të aktivitetit dhe të paktën 30% e të ardhurave të gjenerohen pas vitit të tretë. Në këtë situatë, vetë ligji krijon një kontraditë me ligjin e OJF-ve të cilat përfitojnë nga përjashtimi për TVSH-në sipas pikës 3 të VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014. Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se një

nga tre kriteret që një OJF duhet të përmbushë që të përfitojë përjashtim nga TVSH-ja është: “Furnizimet e krijuara nga organizatat jo-fitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë me sektorin tregtar fitimprures”. Të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore të organizatës. Në këtë rast, ligji bie në kundërshti me ligjin e OJQ-ve që përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së sipas VKM-së nr. 953, që daton në 29.12.2014. Për më tepër ky vendim qeverie deklaroi se aktiviteti ekonomik i OJF-ve konsiderohet si aktivitet dytësor, ndërsa për një NS duhet të jetë aktivitet parësor.

Në këtë rast për NS-të (OJF), përjashtimi nga TVSH-së është i vështirë për t’u përfituar.

- Sërisht, nga **pika 2**, nuk është i qartë momenti kur një OJF mund ta përfitojë statusin e NS. Pasi, duke qenë se është deklaruar se NS-ja mund të arrijë të paktën 20% të të ardhurave pas vitit të dytë të aktivitetit. Lind pyetja nëse mund ta përfitojë statusin në vitin kur të ardhurat janë më pak se 20% e të ardhurave totale, me kushtin për të arritur 20% në vitin e dytë?
- Një tjetër problem që rrjedh nga **pika 2** e këtij neni, kur limiti minimal i përcaktuar për vitin e dytë ose të tretë (20-30%) arrihet, por psh. në fund të vitit të tretë NS-ja përfiton një grant të madh (pasi merr të ardhura nga projekte të ndryshme, donacione ose subvencione), çka ul përqindjen e aktivitetit ekonomik nën pragun e përcaktuar në Ligj. Mund të ndodhë që nga të ardhurat totale vjetore të NS-së (OJF-së), të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik mund të jenë më pak se përqindja e specifikuar në pikën 2 të këtij neni. Në këtë situatë, nuk është e qartë nëse NS-ja do të humbiste “Statusin”.
- **Neni 8, pika 3**, nuk është e qartë nëse kontributi i vullnetarëve është një kërkesë e Ligjit.
- **Neni 10 (objekti i aktivitetit)**, përveç këtij neni të ligjit, me VKM nr. 16, 12.01.2018, është aprovuar veprimtaria e NS-ve në aktivitete ekonomike në sektorë të ndryshëm. Kjo sjell nevojën për të shtuar në këtë nen, **një pikë të re 3**, si nevojë për krijimin e një mekanizmi koordinativ institucional për mbështetjen e NS-ve, sepse aktiviteti i NS-ve është ndër sektorial, dhe nuk mbështetet vetëm tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- **Neni 12 (forma juridike)**, bazuar në situatën aktuale të OJF-ve, mundësitë e tyre që operojnë në Shqipëri dhe për të krijuar NS, nuk ju mundesohen, ose lihen jashtë këtij kuadri ligjor forma të tjera si biznes social, kooperativat të cilat nuk përkasin zyrtarisht në këtë ligj. Gjatë procesit të konsultimit me fokus-grupin, ka skepticizëm se NS-të mund të zhvillohen vetëm nga OJF, dhe grupet e konsultimit shprehën se ekzistojnë forma të tjera ligjore me mision social dhe duhet të përfitojnë nga programet mbështetëse publike.
- **Neni 13 (njohja dhe refuzimi i statusit)**, ka një perceptim se duhen shumë dokumenta për të përfituar statusin. Përsa i përket statusit, në rast se NS-ja nuk e merr konfirmimin brenda 30 ditëve, “parimi i njohjes me heshtje” duhet të aplikohet.
- **Neni 14 (humbja e statusit)**, në pikën 5, në rastin kur NS-ja humbet statusin. Sërisht, ligji nuk e merr në konsideratë faktin që një NS, nëse

e humbet statusin mund të vazhdojë si OJF. Ligji parashikon se pas humbjes së statusit, pasuria e krijuar gjatë periudhës kur organizata kishte statusin, mund të përdoret për interes publik ose t'i kalohet një NS-je tjetër! Propozimi për ndryshim të pikës 5, është: **“Vetëm në rast se pasuria është krijuar nga fondet publike, mund të përdoret për interes publik ose t'i kalohet një NS-je tjetër”**.

- **Neni 17 (Mos Shpërndarja e fitimit)**, duke ju referuar pikës 4, për fitimin indirekt dhe shpërblimin e marrë nga anëtarët ka një limit në vlerë mbi 20%. Nuk është e qartë se në çfarë pjese të legjislacionit gjendet kjo referencë.
- **Neni 23 (kundravajtjet administrative dhe sanksionet)**, në pikën 1 (a) theksohet se: kur NS gjatë periudhës që gëzon statusin, shkel kriteret ekonomike (sipas nenit 8), do të marrë dënim. Në këtë pikë të nenit, duhet të qartësohet rasti kur NS-ja gjatë vitit specifik, të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik i ka më të ulëta se 20%, për arsye të fitimit nga burime të tjera financimi (subvencione, projekte me donatorë), që në tërësi përqindja të shkojë më pak se 20%. A mund të penalizohet NS-ja në këtë rast? Gjithashtu në pikën 2 të këtij neni theksohet: “organi përgjegjës për ndëshkimin e shkeljeve administrative është organi që e zbulon shkeljen”. Në këtë nen duhet të pëcaktohet cili është organi përgjegjës?
- **Neni 25 (regjimi fiskal), duhet të qartësohet regjimi fiskal.** Bazuar në procedurat e tatimore, OJF-të nuk janë subjekt TVSH-je.
- **Neni 26 (format e mbështetjes)**, në pikën 3 të këtij neni, lidhur me format e tjera mbështetëse, nuk ka referim ndaj ligjit të NS-ve por ndaj ligjeve të tjera si; ligji procedurave tatimore, ndihmës shtetërore dhe legjislacionit mbi OJF-të. Kjo dispozitë ligjore duhet të rregullohet duke ju adresuar vetëm ligjit mbi NS-të.
- **Neni 27 (pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik)**, në pikën 1 të këtij neni, mbi të drejtat e NS-ve për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik, platforma dixhitale **e-Procurement** nuk lejon OJF-të/NS-të të marrin pjesë në prokurimin publik.
- **Neni 30 (rregullime plotësuese)**, në fakt, ky nen është esenca e vetë ligjit. Ligji i NS-ve duhet të ishte hartuar me teknika më të qarta legislative dhe do të ishte me i plotë në dispozitat e tij, dhe të sillej si një ligj tërësor “organik” për NS-të, dhe jo duke ju referuar ligjeve të OJF-së, tatimeve apo ndihmës shtetërore.

65 pjesëmarrës nga rajonet e Vlorës, Fierit, Tiranës dhe Shkodrës morën pjesë në dy raundet e konsultimeve të fokus grupeve të organizuara në qytetet e Vlorës dhe Tiranës. Të gjithë pjesëmarrësit treguan interes dhe diskutuan mbi çështjet që lidhen me kornizën ligjore dhe rezultatet e këtyre takimeve në lidhje me çështjet janë:

Informimi, ndërgjegjësimi dhe koordinimi

- Shumica e audiencës nuk ka njohuri për ligjin e NS dhe aktet nënligjore të tij, vetëm pak prej tyre e njohin apo kishin lexuar ligjin, veçanërisht kjo e theksuar me shume në rajonin e Vlorës;
- Përfaqësuesit e OJF-ve pohojnë se në rajonin e Vlorës dhe Fierit, edhe pse ligji u miratua në vitin 2016, nuk kanë patur asnjë aktivitet lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin mbi kuadrin ligjor të NS-ve;
- Ka mungesë të ndërgjegjësitimit për kuadrin ligjor, kryesisht në zonat rurale;
- Nuk ka informacion për NS-të ekzistuese që mund të kenë fituar statusin e “Ndërmarrjes Sociale” në Vlorë ose Fier;
- Nuk ekziston një organizem koordinues / agjensi / strukture e veçantë për të mbështetur rrjetin e NS-ve, përgjegjëse për promovimin e kuadrit ligjor dhe rregullore.

Kapacitetet e OJF për të zhvilluar NS

- Shumica e aktiviteteve të tyre ekonomike bazohen në punën vullnetare;
- Disa nga OJF-të që kanë zhvilluar aktivitete ekonomike përballen me mungesën e mbështetjes për të gjetur ambientin e NS, stafin, njohuritë, lehtësirat për tatimin e qerases, madje edhe kur është dhuruar nga kompanitë private;
- OJF-të ende kanë nevojë për orientim dhe njohuri se si të zhvillojnë një aktivitet ekonomik, edhe pse kanë disa ide të mira dhe madje edhe burime njerëzore.

Çështjet dhe incentivat financiare

- Kuadri ligjor në vetvete nuk ofron për NS ndonjë incentive tatimore ose trajtim preferencial krahasuar me OJF-të.
- Ka mungesë informacioni në lidhje me VKM, nr.85, datë 25.06.2018, për autorizimin e ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ndërmarrjes sociale”.
- OJF-të përballen me shumë vështirësi në gjetjen e burimeve të financimit, përmes donatorëve dhe gjithashtu, sistemi bankar nuk mbështet NS start-ups.

- Ka shumë vështirësi për të konkurruar në tregun konkurrues me kompanitë tregtare, kur burimet njerëzore, siç kërkohet nga Ligji, nuk janë konkurruese në aftësitë për të qenë në gjendje të prodhojnë mallra ose shërbime të konsiderueshme konkurruese për tregun e hapur;
- Ligji i NS nuk lidhen me ligjet e tjera si atë të OJF-ve, ligjin e taksave dhe vetëqeverisjes vendore etj. Kështu, ligji për Vetëqeverisjen vendore nuk lejon që njësitë vendore (bashkitë) të sigurojnë fonde për NS. Ka pak aktivitete sociale të përshkruara për njësitë e qeverisjes vendore në mbështetje të NS, për shkak të mungesës së fondeve;

Çështjet ligjore dhe paqartësitë

- Ligji i prokurimit publik nuk siguron akses për NS-t në tenderat e prokurimeve publike, është e nevojshme të përfshihen konceptet mbi **prokurimin social**, si pjesë e ligjit të prokurimit publik;
- Nevoja për përafrimin e ligjit të NS me kornizën ligjore të BE-së;
- Neni 8 i ligjit të NS ka nevojë për më shumë sqarime, lidhur me kriteret ekonomike, kur të ardhurat e përfituara nga veprimtaria ekonomike mund të jenë më pak se pjesa e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. 20%-shi i të ardhurave të gjeneruara nga veprimtaria ekonomike krijon paqartësi të parashikuara nga ligji, kundrejt xhiros totale vjetore nga OJF-të ose nga NS dhe lidhja me statusin e NS;
- Ligji në vetvete duke përfshirë dhe aktet nenligjore kërkon më shumë përmirësime dhe sqarime.

Funksionimi praktik i NS

- Mënyra e funksionimit të OJF-ve, kur ato janë të përfshira në aktivitetin ekonomik ngrejne disa paqartësi. Kështu, për aktivitetet ekonomike sociale u propozua përdorimi i një numri sekondar të NIPT / personit të tatueshëm, si një aktivitet ekonomik i veçantë nga operacioni parësor i OJF-ve.

Si konkluzion nga procesi i konsultimit të focus-grupeve si në Vlorë dhe Tiranë rezultuan se në këtë ligj, i cili përbëhet nga 31 nene, të paktën 11 nene kanë nevojë për përmirësime thelbësore, duke iu referuar neneve të cituara më sipër. Forma juridike e ndërmarrjeve sociale, bazuar në nenin 12 të ligjit, në mënyrë të pashmangshme lidh formën ligjore të ndërmarrjeve sociale me OJF-të. Rrjedhimisht, kjo reflektohet në mënyrën se si ndërmarrjet sociale janë themeluar, regjistruar, organizuar si dhe në menaxhimin e tyre të brendshëm. Kjo zgjidhje legjislative konsiderohet kufizuese dhe nuk nxit zhvillimin e NS-ve duke lënë jashtë format të tjera organizimi nga ana ligjore.

Bazuar në praktikat më të mira në vendet e BE-së, format juridike të NS-ve mund të jenë të ndryshme, madje edhe përtej formës klasike të një OJF-je. Për shembull, ndërmarrjet sociale mund të jenë:

- Shoqeri tregtare në pronësi të të punësuarve (në Gjermani është një model i përhapur dhe i inkurajuar nga legjislacioni);
- Kooperativat, ose si në Shqipëri, kompanitë e bashkëpunimit bujqësor, (Ligji Nr. 38/2012);
- Unionet e kreditit (termi ndërmarrje sociale ka lindur nga nobelisti Muhammed Yunus, në mikrofinancimin për njerëzit e varfër);
- Ndërmarrje të krijuara nga komunitetet lokale (komunitet e biznesit), siç u përhapën gjerësisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe vendet anglosaksone;
- Filialet e e organizatave bamirëse që angazhohen në veprimtari tregtare për të mbuluar kostot e tyre;
- Fondet e zhvillimit (trust funds);
- dhe kompanitë tregtare si organizata fitimprurëse, por me objektiva të qarta sociale.

Aspekti më sensitiv është se në shumë vende është praktikë e njohur që si ndërmarrjet sociale dhe kompanitë tregtare kanë të drejtë të gjenerojnë fitime, por me kushte të caktuara, kur në përgjithësi kriteret ekonomike dhe sociale janë plotësuar.

Duke iu referuar Komunikimit nga Komisioni Evropian³: këto kushte janë kryesisht të lidhura me aspektet e mëposhtme:

- Qëllimi social është një e mirë (publike);
- Fitimet riinvestohen me qëllimin e arritjes së objektivave sociale të ndërmarrjes;
- Mënyra e organizimit apo sistemit të pronësisë pasqyron misionin e tyre, duke respektuar parimet demokratike të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes;
- Sigurimi i mallrave dhe shërbimeve për grupet në nevojë; strehimi, kuj-

desi shëndetësor, ndihma për të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara;

- Qëllimi i prodhimit të mallrave ose ofrimi i shërbimeve ka si objektiv social integrimin social dhe profesional të grupeve të disavantazuara.

Gjithashtu, kufizimet lidhur me formën ligjore të NS-ve, të cilat në mënyrë të pashmangshme lidhen vetëm me formën e OJF-ve, shmangin mundësitë shtesë për kontributin që mund të vijnë nga forma të tjera të entiteteve ligjore. Kështu, për shembull, subjektet e mësipërme, siç janë shoqatat e punonjësve, kooperativat, unionet e kreditit, bizneset e komunitetit, filialet ose organizatave bamirëse dhe fondet e zhvillimit, përjashtohen për të marrë statusin e Ndërmarrjes Sociale.

Sa i përket bizneseve tradicionale, shpesh ata duan të kontribuojnë në aktivitete sociale përmes praktikave të tyre menaxheriale, të kombinuara me objektivat shoqërore (p.sh. krijimi i ndërmarrjeve sociale, degëve, filialeve apo ndërmarrjeve që lidhen me biznesin kryesor tradicional). Në këtë mënyrë, ata mund të përdorin kapacitetet ekzistuese administrative dhe njerëzore në dispozicion të stafit të tyre, të cilët janë të aftë dhe të specializuar në ushtrimin e aktiviteteve ekonomike që gjenerojnë fitime dhe bashkimin me stafin e dedikuar për njerëzit në nevojë dhe arritjen e objektivave sociale.

Në përgjithësi, bizneset nuk kërkojnë të angazhohen në organizimin e formave të tilla ligjore si OJF-të, organizimi dhe struktura e të cilave nuk pasqyrojnë format tipike të kompanive komerciale.

Ekziston një nivel i ulët i njohjes dhe kuptimit të ligjit të NS-ve, gjë që sjell nevojën për të organizuar disa seminare dhe workshope në këtë fushë.

Ekziston nevoja për të organizuar aktivitete promovuese të dizenuara mirë në mbështetje të OJF-ve në një orientim më të mirë drejt NS-ve të qëndrueshme si dhe për të ndërtuar programe / projekte specifike për zhvillimin e ideve bazë të OSHC-ve drejt aktiviteteve ekonomike të NS-ve start-up.

Numri i NS-ve që ofrojnë shërbime sociale është rritur me shpejtësi në të gjithë botën dhe po arrin popullim të konsiderueshem. NS-të sjellin dinamizëm në ekonomitë lokale duke zhvilluar produkte dhe shërbime të reja, duke marrë rrishtet që ofruerit e shërbimeve publike dhe private nuk janë në gjendje të ndërmarrin dhe të krijojnë kapacitete lokale. Në këtë kuadër, shumë qeveri shfrytëzuan mundësinë për të njohur dhe mbështetur NS-të si partnerë në një mision të përbashkët për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.

Përvoja ndërkombëtare tregon se decentralizimi i shërbimeve publike ofron një mundësi për këto aktorë të rinj (NS) për të hyrë në tregun e ofrimit të shërbimeve me përfitimet e mëposhtme:

- Plotësimi i boshllëkut të aksesit ndaj shërbimeve sociale,
- Përmirësimi i cilësisë dhe barazisë së shërbimeve dhe punësimit, dhe
- Rritja e kohezionit social dhe përfitimeve ekonomike. Megjithatë, natyra hibride e NS mund të çojë që ato të ndikohen më rëndë nga kufizimet në mjedisin e biznesit dhe mund t'u nënshtrohen atyre vështirësive që nuk përballen nga ndërmarrja kryesore⁴.

Këto përfshijnë:

